



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-30297/22
Kaçanik, 30.11.2022

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 68 të Ligjit Nr.03/L-040-Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 të datës 04/ Qershor 2008), të Kapitullit III të Ligjit Nr. 06/L -081- Për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/4 Qershor 2019), të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ (MPL) 03/2020 për Transparencë në Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 Nëntor 2022, mori këtë:


V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT
PËR TRANSPARENCË 2023-2026

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Kaçanikut, me tekstin e mëtejshëm, **Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026**.
2. Plani i Veprimit nga pika 1. e këtij vendimi, ka për qëllim t'i ofroj publikut qasje të lehtë në monitorim dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikimin e të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik si dhe rritjen e mundësive të qytetarëve në vendimmarrje.
3. Plani i Veprimit për Transparencë 2023-2026 përmban numër të protokollit 01Nr. 104/02-30297/22, i përmbledhur në 21 faqe, i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e Planit të do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, përmes Zyrës së Informimit dhe mekanizmat tjerë relevantë.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës (përmes saj njoftohet Zyra e Informimit mekanizmat tjerë relevantë); Drejtoria e Administratës së Përgjithshme; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursehi



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E KAÇANIKUT
 OPŠTINA KAÇANIK



Data	28.12.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	60/01-33724-1
		Shtojcë	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemajl Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 14.12.2022 020-1093
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanik	
Lloji i aktit:	Vendim i kuvendit të komunës së Kaçanik	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01Nr. 104/02-30297/22, për aprovimin e Planit për transparencë 2023-2026.
I miratuar më datë: 30.11.2022
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.12.2022

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

MAPL, konstaton së Vendimin 01Nr. 104/02-30297/22, nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2022, është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe Ligjin Nr.06/L-081-per Qasje në dokumente publike si dhe nenin 15 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) 03/2020 për transparencë në komuna.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 30.11.2022, me 26 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.